



PËRSE TË DHËNAT E MIA PERSONALE TRANSMETOHEN TEK EUODAC?

Lloji A

KËRKUESIT E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE



PËRSE PO E MARR KËTË BROSHURË?

Keni paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në këtë vend, që njihet gjithashtu si azil.

Kjo broshurë ofron më shumë informacion mbi të dhënat që do të ruhen nga autoritetet dhe mbi periudhën e ruajtjes.

PËRSE MË DUHET TË JAP GJURMËT E GISHTAVE DHE TË FOTOGRAFOHEM?

Autoritetet në këtë vend do t'ju marrin gjurmët e gishtave dhe do t'ju fotografojnë. Këto të dhëna do të transmetohen te baza e të dhënave Eurodac së bashku me informacionin rreth identitetit tuaj dhe informacione të tjera përkatëse.

Eurodac lidh kategori të caktuara të personave që nuk janë shtetas të një vendi të BE+ me grupin e tyre unik të gjurmëve të gishtave dhe fotografive.

Kjo bazë të dhënash përdoret nga 31 vende të BE+ që mund t'i përpunojnë të dhënat tuaja për të marrë informacione rreth jush. Vendet e BE+ janë listuar në fund të kësaj broshure.



ÇFARË ËSHTË RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E AZILIT DHE MIGRACIONIT?



Vendet e BE+ miratuan një ligj të përbashkët të quajtur Rregullorja për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit, që ndihmon në përcaktimin e vendit përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Ky ligj lejon gjithashtu që vendet e BE+ të ndihmojnë njëra-tjetrën në rastet kur një vend mbingarkohet me kërkesa në një periudhë kohore të caktuar.

Ju garantohet se një nga vendet e BE+ do ta shqyrtojë kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare, por nuk mund të zgjidhni se cili vend i BE+ do të jetë përgjegjës. Vendimi për përcaktimin e shtetit që do të shqyrtojë kërkesën tuaj do të merret sipas rregullave të Rregullores për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit.

Në rast se ju lëvizni pa leje në një vend tjetër të BE+ dhe ju merren sërish gjurmët e gishtave, atëherë të gjitha të dhënat tuaja që ruhen në Eurodac do të aksesohen nga autoritetet e atij vendi.

Aktualisht ndodheni në finlandez i cili është një vend i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra.



CILAT INFORMACIONE RUHEN NË EURODAC?



Informacionet e mëposhtme ruhen në çdo rast:

- gjurmët tuaja të gishtave
- një fotografi e fytyrës suaj
- të gjithë emrat që keni aktualisht ose që keni pasur në të shkuarën
- datëlindja juaj
- vendlindja juaj
- shtetësia ose shtetësitë tuaja
- gjinia juaj
- kopjet e dokumenteve të identitetit ose udhëtimit që keni përdorur, kur disponohen, duke përfshirë informacionin rreth autenticitetit të tyre
- ID-ja e përdoruesit e nëpunësit që ju mori gjurmët e gishtave dhe ju fotografoi, si dhe datat e marrjes dhe transmetimit të të dhënave tuaja
- vendi ku paraqitet kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare
- data e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Informacionet e mëposhtme do të ruhen gjithashtu në Eurodac, sipas nevojës:

- vendi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj
- vendi i zhvendosjes i BE+, nëse jeni zhvendosur
- fakti nëse kërkesa juaj është refuzuar dhe nuk keni të drejtë që të qëndroni në vendet e BE+
- fakti nëse kërkesa juaj është shqyrtuar në kuadër të procedurës në kufi dhe është refuzuar, ose nëse kërkesa juaj është konsideruar si e tërhequr
- informacionet rreth çdo vize që ju është lëshuar nga një vend i BE+
- informacioni rreth çdo here që jeni larguar nga rajoni i vendeve të BE+
- informacioni rreth faktit nëse keni pranuar ofertën për t'u rikthyer vullnetarisht në vendin tuaj të origjinës.

Ju gëzoni të drejtën të aksesoni dhe të ndryshoni informacionet e pasakta që janë ruajtur në Eurodac dhe të kërkonti fshirjen e informacionit tuaj në rast se ky i fundit është trajtuar në mënyrë të paligjshme. Mund të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave për të kryer këto veprime. Të dhënat e kontaktit të kontrolluesit të të dhënave mund të gjenden në broshurën me titull "**Çfarë duhet të dini rreth Eurodac**".

➤ PËR SA KOHË RUHEN TË DHËNAT E MIA PERSONALE NË EURODAC?



Informacioni juaj do të ruhet për 10 vjet e më pas do të fshihet automatikisht.

Të dhënat tuaja do të fshihen në rast se ju merrni shtetësinë në një vend të BE+ përpara përfundimit të kësaj periudhe. Fshirja e të dhënave tuaja nuk do të ndikojë te statusi juaj në vendin ku keni marrë shtetësinë.

➤ A RUHEN INFORMACIONE TË TJERA NË EURODAC?

Rezultati i kontrollit tuaj të sigurisë do të ruhet nëse autoritetet zbulojnë se ka gjasa që ju:

- të posedoni armë
- të jeni të dhunshëm
- të jeni përfshirë në vepra penale të lidhura me terrorizmin
- të keni kryer një krim të rëndë për të cilin mund të arrestoheni në një tjetër vend të BE+.

Në raste të tilla, do të konsideroheni se përbëni kërcënim për sigurinë e brendshme. Ky informacion do të ruhet në Eurodac së bashku me arsyen ose arsyet përkatëse të detajuara më sipër.

Ky informacion do të fshihet nëse vendet e BE+ nuk ju konsiderojnë më si kërcënim për sigurinë e brendshme.

Ju gëzoni të drejtën të aksesoni dhe të ndryshoni informacionet e pasakta që janë ruajtur në Eurodac dhe të kërkonti fshirjen e informacionit tuaj në rast se ky i fundit është trajtuar në mënyrë të paligjshme. Mund të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave për të kryer këto veprime. Të dhënat e kontaktit të kontrolluesit të të dhënave mund të gjenden në broshurën me titull "**Çfarë duhet të dini rreth Eurodac**".

SHËNIMET E MIA

SHËNIMET E MIA



Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.